




Republika E Kosovës
Republika Kosova
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

I	Data	30.09.2024	Vendi	Kaçanik
	Nj. org.		Numri	Sitejce
				01-370/01-25135/24

KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga z. Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Konz. "PLUS TRADE" L.L.C & N.N.P. "ATC COM" Shpk nga ferizaji përfaqësuar nga Përparim Dalloshi (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ridizajnimii hapsirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit

me numër identifikues: 652-24-8148-5-2-1

KA652/2456/521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Ridizajnimii hapsirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit

84në < sipas dosjes > pjesë

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total është 139,155.03 € ,

dhe me fjalë (Njëqindëetridhjetëenëntëmijëenjëqindëepesëdhjetëepesëeuro e 03/100 centë)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe situacioni përfundimtar paguhet 15% të vlerës së kontratës dhe në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve .

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Përparim Dalloshi	Emri:	IzahirKuka
Pozita:	Drejtor	Pozita:	U.d. Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.09.2024	Data:	30.09.2024
Vula:		Vula:	

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Punë**" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "**Kontraktuesi**" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "**Menaxheri i Projektit**" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "**Çmimi Kontratës**" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "**Vendi i ndërtimit**" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "**Pajisjet e kontraktuesit**" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "**Skicat**" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "**KPK**" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "**KVK**" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës

që do të nënkontrktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njuh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrisë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 8 Programi

8.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuara, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

Neni 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 11 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëherë nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 12 Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

12.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

Neni 13 Korigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do të zgjatet deri sa të përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korigjoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

Neni 14 Paramasa dhe Paralogaria

14.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 15 Vërtetimet e pagesës

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuar të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 16 Pagesa

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 17 Shkaqet për kompensim

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

Neni 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit.

Neni 20 Parapagimi

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me

parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 21 Mbajtja e Parasë

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do të tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do t'i paguhet Kontraktuesit kur të kalojë periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

Neni 22 Siguria e ekzekutimit

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e moszekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 23 Kostoja e Riparimeve

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

Neni 24 Përfundimet dhe Certifikata e pranimit të punëve

24.1 Pasi që kryesisht të jenë përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkruara në kontratë, kontraktuesi mund të njoftoj Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryej të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuese të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuese për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve të pranimit të kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do të lëshoj Certifikatën e pranimit të punëve, duke cekur datën, sipas mendimit të tij, e përfundimit të punëve ose do të jap instruksione për punët të cilat duhet të kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit të kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, ka të drejtën e pranimit të kësaj Certifikate brenda 21 ditëve të kompletimit të punëve dhe të përmirësimit të defekteve të cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend punimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

Neni 25 Llogaritja përfundimtare

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët të cilat duhen të paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do të lëshoj Certifikatën e periudhës garantuese të defekteve dhe do të certifikoj cilëndo pagese finale e cila duhet të paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit të llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren të meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë

apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas riorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do të vendos mbi shumën e cila do të paguhet Kontraktuesit dhe do të lëshoj certifikatën mbi pagesën.

Neni 26 Shkëputja e kontratës

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 27 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 28 Prona

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 29 Lirimi nga Ekzekutimi

29.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij

vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 30 Forca madhore

30.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [SHQIPE] .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <i>[shëno numrin]</i> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <i>[shëno numrin]</i> ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i Projektit është: Eljesa Begunca
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë prej 03.10.2024 ku e gjith plani artohet në ditarë ndërtimor.
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë mbrenda 50 ditëve .
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periudha garantuere e defekteve është 365 ditë (një vitë) nevlere prej 10 % të vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>[shëno numrin]</i> ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>[0.25 %]</i> për

		ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 %] e Çmimit final të Kontratës.
Kushtet e pagesës	20.1	Kushtet e pagesës janë: Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe situacioni përfundimtar paguhet 20% të vlerës së kontratës dhe në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve .
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>[shëno përqindjen]</i>
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 13,915.50€
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	<i>Cdo mosmarrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore, në rast se nuk zgjidhet në mënyrë miqësore kompetente është Gjykata komunale Kaçanik.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	<i>[shëno të dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Komunale Kaçanik b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>

Ridizajnimi i hapësirës publike të Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit.

Nr. R.	Pozicionimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Vlera (€)
PUNËT PËRGADITORE					
1					
1.1	Pregaditja e punishtes duke përfshirë demolimet, rrethimin dhe të gjitha aktivitetet që mundësojnë fillimin dhe mbarvajtjen e sigurt të punimeve.	paushall	1.00	1,200.00 €	1,200.00
1.2	Piketimi gjedezik për fushë dhe elementet tjera përcjellëse.	paushall	1.00	1,200.00 €	1,200.00
Gjithësej 1					2,400.00
PUNËT E DHEUT					
2					
2.1	Gërmimi dhe transporti deri në deponi me gjatësi max 15km I dheut të kategoris III dhe IV me trashësi rreth d=45cm duke e përfshirë fushën, tribunat, muret rrethuse, kubëza ekzistuese, drunj, shkurre, gjysmeshkurre dhe të gjitha elementet përcjellëse sipas projektit.	m ³	822.60	8.00 €	6,580.80
2.2	Gërmimi dhe transporti deri në deponi me gjatësi max 15km I dheut të kategoris III dhe IV me thellsi maksimale 1.5m gjersi të kanalit t=70cm për vendosjen e gypave të kanalizimit.	m ³	216.00	8.00 €	1,728.00
2.3	Planifikimi, ngjeshja dhe kompaktimi I në bazës pas përfundimit të grryerjes me Mv>30Mn/m ²	m ²	1,828.00	1.00 €	1,828.00
2.4	Furnizimi, transporti dhe punimi I shtresës nga Gjeotekstili 350gr/m ²	m ²	1,828.00	2.00 €	3,656.00
2.5	Furnizimi, transporti dhe punimi I rëres për mbulimin e gypave të kanalizimit atmosferik.	m ³	63.00	15.00 €	945.00
2.6	Furnizimi, transporti dhe punimi I tamponit 0-63.5mm për mbulimin e kanalit të kanalizimit atmosferik.	m ³	158.40	12.00 €	1,900.80
2.7	Furnizimi, transporti dhe punimi I shtresës nga agregati i thyer guri gëlqerorë (0-63 mm), i ngjeshur me trashësi 30cm me Mv>60Mn/m ² nën themele të mureve rrethuse dhe mureve të tribunave të fushës sipas vizatimit.	m ³	52.50	15.00 €	787.50
2.8	Furnizimi, transporti dhe punimi I shtresës nga agregati i thyer guri gëlqerorë (0-63 mm), i ngjeshur me trashësi 30cm me Mv>60Mn/m ² , në hapsirat u fushave, shtegut për ecje dhe hapsirave tjera sipas vizatimit.	m ³	548.40	12.00 €	6,580.80
2.9	Furnizimi, transporti dhe punimi I shtresës nga agregati i thyer guri gëlqerorë (0-31.5mm), i ngjeshur me trashësi 15cm me Mv>80Mn/m ² , në hapsirat u fushave, shtegut për ecje dhe hapsirave tjera sipas vizatimit.	m ³	274.20	12.00 €	3,290.40
2.10	Furnizimi, transporti dhe punimi I shtresës nga agregati i thyer guri 0-4 mm adkuat për pjesën e këndit të lojërave.	m ³	65.70	15.00 €	985.50
Gjithësej 2					28,282.80 €

3	PUNËT E , KUBËZAT, ANËSORET,ELEMENTET VINKELL				
3.1	Sigurimi dhe montimi i gurëve skajor nga betoni i parapregaditur 8/20cm me klas C35/45 - M100.Në llogari hyn edhe punimi I bazës prej betoni.	m'	475.00	10.00 €	4,750.00 €
3.2	Sigurimi, transporti dhe shtrimi i rërës të fraksionit 0-4 mm, për krijimin e bazës për vendosjen e kubëzave të betonit.	m ³	91.40	15.00 €	1,371.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i mureve Vinkell të parafabrikuar nga beton armeja me kualiteti C35/45 me formë L, lartësi h=120cm,gjerësia a=100cm shputë b=65cm dhe trashësi t=12cm.Sipas detalit të dhënë në projekt.	copë	28.00	170.00 €	4,760.00 €
4.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i MURI KËNDOR Vinkell të parafabrikuar nga beton armeja me kualiteti C35/45 me formë kendi, gjersi lartësi h=120cm, shputë b=50cm dhe trashësi t=12cm. Sipas detalit të dhënë në projekt.	copë	4.00	155.00 €	620.00 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i mureve Vinkell të parafabrikuar nga beton armeja me kualiteti C35/45 me formë L, lartësi h=55cm, shputë b=35cm dhe trashësi t=12cm.	copë	34.00	85.00 €	2,890.00 €
3.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i blloqeve (elementeve) Vinkell të parafabrikuar nga beton armeja me kualiteti C35/45 me gjersi b=50cm, gjatësi b=100cm dhe trashësi t=50cm.	copë	29.00	145.00 €	4,205.00 €
3.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i MURI KËNDOR Vinkell të parafabrikuar nga beton armeja me kualiteti C35/45 me formë kendi, gjersi lartësi h=55cm, shputë b=50cm dhe trashësi t=12cm.	copë	18.00	85.00 €	1,530.00 €
4.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i mureve Vinkell të parafabrikuar nga beton armeja me kualiteti C35/45 me formë L, lartësi h=140cm,gjerësia a=100cm shputë b=65cm dhe trashësi t=12cm.Sipas detalit të dhënë në projekt.	copë	8.00	195.00 €	1,560.00 €
5.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i MURI KËNDOR Vinkell të parafabrikuar nga beton armeja me kualiteti C35/45 me formë kendi, gjersi lartësi h=140cm, shputë b=50cm dhe trashësi t=12cm. Sipas detalit të dhënë në projekt.	copë	16.00	175.00 €	2,800.00 €
6.7	Furnizimi, transporti dhe punimi I Hidroizolimit të nxehtë Kondor 4mm. Shiriti bituminoz vendoset me saldime me flakë në sipërfaqen e lyster me parë me lyster te ftohtë me bitulit. Ky pozicion realizohet ne pjesen ku bashkohen elementet e parafabrikuara.	m ²	9.45	25.00 €	236.25 €
3.8	Furnizimi, transporti dhe montimi i kubëzave të betonit ngjyra percaktohet nga investitori, me trashësi t=10cm (dy-shtresore). Shtresa e parë me trashësi t=80mm nga betoni i presuar klasë c35/45 ndërsa shtresa e dytë nga graniti me trashësi t=20mm. Kubëzat duhet të jenë me aditiv kundër ujëpërshkueshmërisë të aplikuar në të dy shtresat. Kubëzat duhet të jenë me rezistencë në çarje prej 3.6 Mpa, konform standardit EN 1338. Në këtë pozicion hyn edhe punimi I shtresës së rërës nën kubëza me trashësi 4 cm (furnizimi dhe transporti), ngjeshja e tyre pas montimit me mekanizëm përkatës, mbulimi I fugave me rërë dhe pastrimi përfundimtarë i tyre. Lloji dhe dizajni i kubëzave të caktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	840.00	10.00 €	8,400.00 €
					33,122.25 €

4		BETONI DHE ARMATURA			
4.1	Furnizimi, transporti, pregaditja dhe vendosja e betonit për muet mbrojtëse me h=120cm (sipas detaleve), klasa e betonit C30/37 i papërshkushem nga uji (Betoni të jetë i natyralizuar dhe i paster pas largimit të pahive e nuk duhet të permirsohet me llaçë shtesë).	m ³	132.50	110.00 €	14,575.00 €
4.2	Furnizimi dhe vendosja e armaturës në strukturat e betonit, lloji S500. Krahas sasisë në specifikim është llogaritur edhe 3% për humbje nga prerja.	kg	6,723.00	1.20 €	8,067.60 €
Gjithësej 4					22,642.60 €

5		DRENAZHIMI			
5.1	Germimi i dheut të kategorisë së III-IV-të me transport i kanaleve të kanalizimit, (thellsi 1.5-2.0m, gjersi b=0.80m).	m'	259.20	5.00 €	1,296.00 €
5.2	Furnizimi, transporti dhe mbushja e kanaleve me rërë nën anash dhe mbi gyp me trashësi t=20cm dhe pjesen tjetër me tampon 0-63.5mm	m'	235.00	10.00 €	2,350.00 €
5.3	Furnizimi, transporti, pregaditja dhe vendosja e rigolave nga betoni me klasë C30/37 i papërshkushem nga uji dhe i çendrushem ndaj ngricave me gjersi b=35cm (Betoni të jetë i natyralizuar).	m'	55.00	10.00 €	550.00 €
5.4	Furnizimi dhe ndërtimi i pusëve kontrollues nga betoni i armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaç çimentoje. Për secilën pusët është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të cilin montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusëtës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante, me thellsi mesatare h=1.8m	copë	6.00	170.00 €	1,020.00 €
5.5	Furnizimi transporti montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, për pesha të rënda. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	copë	6.00	175.00 €	1,050.00 €
5.6	Furnizimi transporti montimi dhe betonimi i ujëmbledhsave prej gize, për pesha të rënda. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	copë	6.00	165.00 €	990.00 €
5.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorë. Paga bëhet për 1m' të gypit të montuar komplet, për kolektorë DN- 200 mm	m'	30.00	5.80 €	174.00 €
5.8	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorë. Paga bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet, për kolektorë DN- 250 mm	m'	150.00	7.50 €	1,125.00 €
5.9	Realizimi i pikës shkarkuese të rrjetit të kanalizimit atmosferik në shtratin e lumit Lepenc duke përfshirë edhe kthimin në gjendjen paraintervenimit.	copë	1.00	1,200.00 €	1,200.00 €
Gjithësej 5					9,755.00 €

6	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
NDRIÇIMI					
6.1	Gërmimi i kanalit të gjatë 50 m prej Furnizimit deri te KSHN, kanalit 362 m prej KSHN përgjatë shtegut parkut dhe fushave sportive sipas vizatimeve, me dimensione (80x60)cm, ashtu siç është paraqitur në situacion, për shtrirjen e gypave PE të brinjezuar Ø 50m. Në çmim të kalkulohet edhe largimi i dheut nga punishtja me largësi min 15km. Në këtë pozicion hynë edhe planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m ³	197.76	5.00 €	988.80
6.2	Porosia, transporti dhe vendosja e gypave RESN4 Ø 50 të brinjezuar per pershkim te kabllit prej Trafos deri te kuadri shpërndarës I ndriçimit KSHN dhe pershkim te kabllit prej kuadrit shpërndarës të ndriçimit publik KSHN përgjatë Daljes 1 (N1-1-N13-1) dhe Daljes 2 (N1-2-N-10-2) (gjatësia e kanalit: 50m+190m+175m).	m	415	2.00 €	830.00
6.3	Furnizimi dhe vendosja e kabllor kryesorë furnizuese NAYY- 4x25mm ² prej TS deri te kuadri kryesorë shpërndarës i ndriçimit KSHN.	m	50	5.00 €	250.00
6.4	Furnizimi dhe vendosja e kabllor furnizuese NAYY- 4x16mm ² prej kuadrit shpërndarës të ndriçimit KSHN për furnizimin e trupave ndriçues.	m	370	3.20 €	1,184.00 €
6.5	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shiritit te zinguar Fe/Zn25x4mm ne kanalizimin kabllorik per tokezimin e shtyllave te ndriçimit.	m	370	1.75 €	647.50 €
6.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit (0-4)mm në fundin e kanalit (70m+250)m prej furnizimit deri te KSHN dhe prej KSHN-së deri te trupat ndriçues, kanali është me dimensione (80x60) (10 cm rërë shtrohen në fund të kanalit dhe 20 cm mbi gypin e brinjëzuar Ø70mm).	m ³	33.2	7.00 €	232.40 €
6.7	Mbulimi i kanalit (50m+362m) me dimensione (80x60cm). Mbulimi i tere me zhavor (0-60)mm. Ngjeshja në shtresë çdo 30cm deri në kuotën e terrenit.	m ³	209.16	5.00 €	1,045.80 €
6.8	Furnizimi transporti dhe vendosja e mbrojtës të tipit GAL.	m	362	1.00 €	362.00 €
6.9	Furnizimi transporti vendosja e shiritit identifikues "Rezik tensioni"	m	415	0.50 €	207.50 €
6.10	Blerja, transporti, montimi dhe lidhja e Kuadrit Shpërndarës të ndriçimit elektrik (KSHN) të ngjashëm me tipin KRO-RJ(A) prodh. TEP me mbrojtje IP65 i ndërtuar nga Poliesteri me dim : 1200x800x300 mm, me mbyllje hermetike te kapakut dhe me qelës. Kuadri vendoset në bazamentin prej betoni MB20 të përgatitur konform normave teknike. Pajisja që montohet në kuadër duhet të jetë nga materiali që nuk ndryshket kurse të gjitha lidhjet të mbrohen nga korozioni. Kuadri duhet të përmbajë sipas skicës njëpolare të paraqitur në projekt këto elemente: 1. Njehsorin elektrik trefazor digjital të tipit MT174-D2A44-MK0Z i paisur me nderrues tarifar 3x230/400V: 50Hz I miratuar nga MTI 2. Ndërprerës automatik, 3P, magneto-termik, Tip DPX 100-63A 4. Siguresat automatike katërpolare 50A ; - " "40A ; - " " 32A ; - " " 16A ; - " " 6A 5. Kontaktoret për kyçje automatike të ndriçimit C-44 ,40A,380V 6. Releun digjital astrologjik për aktivizimin automatik te ndriçimit 7. Voltmetrin për kontrollimin e vlerës së tensionit në faza 8. Paket ndërpresin për kapërcim të tregimit të voltmetrit në faza 9. Prizën njëpolare për shërbime e servise brenda kuadrit 10. Llambën ndiçuese në brendi të kuadrit 11. Zbarrat prej bakri për lidhjen dhe përforcimin e përqesve në faza, zbarrën e përqesve të zeros dhe zbarrën e përtokzimit, 12. Shkarkuesit katodik dhe zbarrën për barazimin e potencialit ; Të gjithë elementet elektrik duke përfshirë dhe ormanët distributiv duhet të jenë të ndërtuar sipas normave teknike CE dhe IEC. Komplet kuadri shpërndarës elektrik i ndriçimit KESHN deri të shtylla më e afërt. Lidhja e elemnteve duhet te behet ne baze te skemes njekahore e kuadrit shperndares. 13. Tokezimi i ormanit elektrik me ane te shiritit Fe/Zn 25x4mm si dhe materiali i imet percjelles.	copë	1	550.00 €	550.00 €
6.11	Ndërtimi i bazamentit të betonit MB30, për KESH të ndriçimit me dimensione 80x90x30cm	m ³	0.5	75.00 €	37.50 €

6.12	Betonimi i bazamentit të 26 shtyllave me lartësi 4 m (shtyllat për ndriçimin e parkut dhe hapsirave rreth fushave sportive) (50x50x60)cm me beton të tipit C30/37.	m ³	3.9	75.00 €	292.50 €
6.13	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave për ndriçimin e hapsirave të parkut dhe hapsirave rreth fushave sportive me gjatësi 4 metra në total (mbi tokë), nga çeliku S235JR me hot dip galvanizim dhe me trashësi të mureve 4mm. Shtylla do të fiksohet me mbjellje 0.8m Diametri i shtyllës Φ140- Φ 60 , me trashësi të metalit 3.5 mm(Φ140) – 2.0 mm (Φ 76),Garancion në shtylla - 25 vite. Furnizimi dhe instalimi i llampave LED 22ë (Lantern klasik Led ose ekuivalente) për ndriçimin e hapsirave të parkut të ndërtuar nga aliazhe alumini me mbjellje silikone e rezistueshme ndaj nxehtësis dhe e mbuluar me PMMA. Tensioni: 110 - 270V (50 - 60Hz) Color temperature: Cree, XTE, 4500K Efikasiteti i ndriçueshmërisë: deri 130lm/ë Jetë gjatësia: 100000 orë Mbrojta nga lagështia: IP65 Mbrojta mekanike: IK10 Klasa e sigurisë: I Temperatura: -30 deri +60 grad celsius Shpërndarja e dritës: Asimetrike të paktën 4000lm. Kategoria S5 në pajtim me EN13201 Poashtu drita duhet të plotësoj EN60598 - 1:2008 dhe EN60598 - 2 - 3:2003 Garancioni: 5 vite Forma e trupit ndriqes sipas detaleve në projekt.	copë	26	245.00 €	6,370.00 €
6.14	Furnizimi, transporti dhe vendosja e ndriqesve (Dritave Led me energji diellore të integruara në gur katëror pa kablo energjie apo mirmbajtje. Toleron 12 ton ngarkesa, dimensionet 250x250x60mm, materiali alumin, pjesa e sipërme Polikarbonat I formuar, transparent. Karakteristikat e drites: Drita thihet në pjesën e sipërme, ndizet/fiket nëpërmjet një sensori (rreth 50 lux), 4 orë karikim në diell (900ë/m2) gjeneron 8-10 orë drite. Karakteristikat tjera sipas detaleve në projekt.		40	45.00 €	1,800.00 €
6.15	Matja e tokzimit mbrojtës dhe dhënja e atestit të tokzimit	komplet	1	50.00 €	50.00 €
6.16	Montimi i kabllove në trafostacionin ekzistues	komplet	1	50.00 €	50.00 €
6.17	Shqyrtimet e nevojshme të kabllove dhe tokzimit nga një kompani e licencuar për këto.	komplet	1	50.00 €	50.00 €
6.18	Punë të pa papaparapara në paramasë	komplet	1	100.00 €	100.00 €
Gjithësej 6					15,048.00 €

PUNËT E PARKUT DHE KËNDIT TË LOJËRAVE					
7					
7.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtreses nga dheu organik i ngjeshur me trashësi t=35cm duke përfshir edhe Barin Natyror.	m ²	265.30	7.00	1,857.10
7.2	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drujëve dekorativ me lartësi hmin=2.5m dhe trashësi të trungur Ø80mm (Lloji do të përzgjedhet në konsulta me investitorin).	copë	15.00	55.00	825.00
7.3	Sigurimi i materialit, transporti dhe montimi i ulëseve. Ulëset duhet të jenë të dizajnuara njëjtë sikurse ulësja e cila është e bashkangjitur me fotografi në këtë projekt duke përfshirë nga 2 blloqe betoni te parafabrikuar "Vinkell" me dimensione 100*50*50 në të cilën montohet pjesa e nga druri si dhe pjesa mbeshtetese sipas detalit. Në llogari hyn punimi i bazës prej betoni për shtangimin e tyre dhe montimi i tyre. Llogaria të bëhet për copë të ulëseve.	copë	14.00	210.00	2,940.00
8.3	Sigurimi i materialit, transporti dhe montimi i ulëseve për te këndi i lojërave. Ulëset duhet të jenë të dizajnuara njëjtë sikurse ulësja e cila është e bashkangjitur me fotografi në këtë projekt duke përfshirë nga 1 bllok betoni te parafabrikuar "Vinkell" me dimensione 100*50*50 në të cilën montohet pjesa e nga druri si dhe pjesa mbeshtetese sipas detalit. Në llogari hyn punimi i bazës prej betoni për shtangimin e tyre dhe montimi i tyre. Llogaria të bëhet për copë të ulëseve.	copë	6.00	225.00	1,350.00
7.4	Furnizimi i materialit, transporti dhe montimi i shportave. Shportat duhet të jenë të dizajnuara njëjtë sikurse shporta e cila është e bashkangjitur me fotografi në këtë projekt. Në llogari hyn punimi i bazës prej betoni për shtangimin e tyre dhe montimi i tyre. Llogaria të bëhet për copë të shportave.	copë	27.00	95.00	2,565.00
Gjithësej 7					9,537.10 €

PUNËT E MBISHKRIMIT "KAÇANIK"					
8					
8.1	Furnizimi, transporti, pregaditja dhe vendosja pllakës së çelikut të galvanizuar dhe plastifikuar (dim: 960x60x1.2cm) në të cilën do të montohen shkronjat KAÇANIK, pllaka e çelikut iknastrohet në bazamentin e betonit me anë të bulonave M19 në dy anet e pllakes në çdo 50cm. Bulonat ankerohen para betonimit në pllaken beton arme me gjatësi Lmin 80cm.	kg	600.00	2.85 €	1,710.00 €
8.2	Furnizimi, transporti, pregaditja dhe vendosja e mbishkrimit KAÇANIK në bazamentin e ndërtuar më parë, shkronjat janë nga çeliku me trashësi 8mm i galvanizuar dhe plastifikuar i cili saldohet sipas detaleve të dhëna në projekt. Lartësia e shkronjave është: 150 cm, gjersia 40cm ndërsa gjatësia e mbishkrimit duke përfshirë të gjitha shkronjat është 898 cm. Ky pozicion përfshinë edhe saldimin e shkronjave mbi pllaken e Çelikut në tërë gjatësinë kontaktuese. Ngjyra e shkronjave do të jetë e njejt ose edhe e ndryshueshme sipas kërkesës së investitorit.	kg	1,900.00	3.15 €	5,985.00 €
8.3	Furnizimi, transporti dhe montimi pllakave të granitit natyral me ngjyrë të zezë me trashësi t=2.0 cm, duke përfshirë edhe përpunimin e këndeve. Në llogari hyn ngjitësi adekuat për përdorim të jashtëm dhe fugat.	m ²	18.35	45.00 €	825.55 €
Gjithësej 8					8,520.55 €

9	PUNËT E FONTANËS				
9.1	Furnizimi, transporti, pregaditja dhe vendosja e betonit për pllaken e Fontanes (sipas detaleve), klasa e betonit C35/40 i papërshkushem nga uji (Betoni të jetë I natyralizuar dhe I paster pas largimit të pahive e nuk duhet të permirsohet me llaçë shtesë).	m ³	0.70	85.00 €	59.13 €
9.2	Furnizimi, transporti, pregaditja dhe vendosja e betonit për per konstruksionin e Fontanes (sipas detaleve), klasa e betonit C35/40 i papërshkushem nga uji (Betoni të jetë I natyralizuar dhe I paster pas largimit të pahive e nuk duhet të permirsohet me llaçë shtesë).	m ³	0.39	85.00 €	33.15 €
9.3	Furnizimi, transporti dhe montimi pllakave të granitit natyral me ngjyrë të hirtë me trashësi t=2.0 cm, duke përfshirë edhe përpunimin e këndeve. Në llogari hyn ngjitësi adekuat për përdorim të jashtëm dhe fiksimi me bulona sipas detalit në projekt.	m ²	5.05	45.00 €	227.45 €
9.4	Furnizimi, transporti dhe montimi pllakës nga granitit natyral me ngjyrë të hirtë me trashësi t=6.0 cm, duke përfshirë edhe përpunimin e këndeve e cila vendoset ne pjesen e sipërme të Fontanes. Në llogari hyn ngjitësi adekuat për përdorim të jashtëm dhe fiksimi me bulona sipas detalit në projekt.	copë	1.00	60.00 €	60.00 €
9.5	Furnizimi, transporti dhe montimi pllakës nga granitit natyral me ngjyrë të hirtë me trashësi t=3.0 cm, duke përfshirë edhe përpunimin e këndeve e cila vendoset ne pjesen e mbi bateri(çezmë) të Fontanes. Në llogari hyn ngjitësi adekuat për përdorim të jashtëm dhe fiksimi me bulona sipas detalit në projekt.	copë	2.00	60.00 €	120.00 €
9.6	Furnizimi, transporti dhe montimi i baterive (çezma) duke përfshirë gypin vazhdues sipas detalit në projekt.	copë	4.00	100.00 €	400.00 €
Gjithësej 9					899.72 €

10	SISTEMI I UITJËS				
10.1	Trasimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike	m'	160.0	3.0	480.0
10.2	Gërmimi i dheut të kateg.IV dhe V me makinë dhe dorë, me gjerësi b=0.6 m dhe thellësi mes.=1.2 m				0.0
a	-Me makinë 90 %	m³	172.8	10.0	1,728.0
b	-Me makinë 10 %	m³	19.2	25.0	480.0
10.3	Sigurimi dhe vendosja e rërës nën, mbi dhe anash gypit, fraksion 0-4mm, me trashësi d=30cm, me planifikim dhe ngjeshje. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%	m³	24.0	15.0	360.0
10.4	Mbulimi i kanalit me dheun e germuar me ngjeshje 20-30 cm	m³	115.2	5.0	576.0
10.5	Sigurimi dhe vendosja e shiritit sinjalizues me shenjen " Kujdes Ujesjellsit" per gjate kanalit 20-30 cm mbi gypin e ujesjellsit	m'	160.0	1.0	160.0
10.6	Largimi i dheut të tepërt në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, përfshir kof. e shkruftesis K=1.3	m³	52.8	15.0	792.0
10.7	Furnizimi, transporti dhe instalimi i tubave PE, duke përfshirë edhe fittingjet si lidhese, gjysëmldhëse, kthesa, redukues, e materiale të tjera të nevojshme për ekzekutim.				0.0
a	PE, Ø 20mm, PN 10 bar.	m'	70.0	5.00	350.0
b	PE, Ø 25mm, PN 10 bar.	m'	30.0	7.00	210.0
c	PE, Ø 32mm, PN 10 bar.	m'	40.0	8.50	340.0
q	PE, Ø 40mm, PN 10 bar.	m'	15.0	10.00	150.0
d	PE, Ø 50mm, PN 10 bar.	m'	3.0	12.00	36.0
10.8	Spërkatës për ujitje me shumë funksione, NAT RAIN, metalik/plastik, rrezja 10-12 m				0.0
a	Spërkatës për ujitje 180°	copë	10.0	75.0	750.0
b	Spërkatës për ujitje 360°	copë	9.0	85.0	765.0
c	Kyqja e rrjetit të ujitjes në puseten kryesore, duke përfshirë ujëmatësin DN-50 mm edhe fittingjet si lidhese, gjysëmldhëse, kthesa, redukues, e materiale të tjera të nevojshme për ekzekutim.	paushall	1.0	200.0	200.0
d	Timer automatik Digitale për ujitjen e gjelbrimit (Spërkatës Inteligjente). Kontrolluesi i ujitjes me valë, që komunikon me deri në 32 RTU. Kontrolluesi është i pajisur me një ekran dhe një grup butonash shtytës, i cili lejon konfigurimin e ujitjes në mënyra të ndryshme. Kontrolluesi është përgjegjës për ekzekutimin 24/7 të orarit të ujitjes të parakonfiguruar, monitorimin e gjendjes së tokës, ngjarjet e dështimit, etj.	set	1.0	450.0	450.0
10.9	Testimi i tubit PE 100 sipas përshkrimit në përputhshmëri me kushtet teknike.	m'	160.0	7.0	1,120.0
Gjithësej 10					8,947.00 €

Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Parallojaritura.
Punëkryesi duhet t'ia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim.
Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale.
Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e kualitetit dhe te standardeve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merr pjesë në tender.
OE është i obliguar që t'i sjell edhe certifikatat e garancionit për pasijet në fjalë të cilat paisje duhet të jenë plotësisht të njëjta me të dhënat teknike të përshkruara në katalogje apo broshura, po ashtu duhet të sjellë edhe certifikaten e origjinës së materialeve.

REKAPITULIMI		
1	PUNËT PËRGADITORE	2,400.00 €
2	PUNËT E DHEUT	28,282.80 €
3	PUNËT E , KUBËZAT, ANËSORET,ELEMENTET VINKELL	33,122.25 €
4	BETONI DHE ARMATURA	22,642.60 €
5	DRENAZHIMI	9,755.00 €
6	NDRIÇIMI	15,048.00 €
7	PUNËT E PARKUT DHE KËNDIT TË LOJËRAVE	9,537.10 €
8	PUNËT E MBISHKRIMIT "KAÇANIK"	8,520.55 €
9	PUNËT E FONTANËS	899.72 €
10	SISTEMI I UITJËS	8,947.00 €

TOTALI

139,155.02 €

